



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.1025/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTP “Doqi” me seli në Ferizaj të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” nga Prishtina, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1474/19, të datës 17.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit NTP “Doqi” me seli në Ferizaj, e datës 30.07.2023 ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1474/19, i datës 17.05.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, në pikën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e NTP “Doqi” me seli në Ferizaj me të cilën ka kërkuar që anulohet aktvendimi me nr.01.3.2.2/4141 i datës 20.05.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe të obligohet e paditura që paditësit t’ia kthej mjetet monetare të paguara më tepër si pasojë e rivlerësimit të mallit të zhdoganuar me Deklaratën Unike Doganore me nr.R-4574/06.03.2019, të procedura në Zyrën e Brendshme Doganore në Ferizaj, ndërsa në pikën II të dispozitivit Mbetet në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/4141 i datës 20.05.2019.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që të aprovohet e bazuar ankesa e paditësit e ushtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.1474/19 i datës 17.05.2021, të anulohet si i pabazuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr.1474/19 i datës 17.05.2021, sipas të cili aktgjykim është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës. nr.01.3.2.2/4141 të datës 20.05.2019, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, Bafti Ademi B.I me emër tregtar NTP “Doqi”, për rishqyrtimin e vendimit nr.R-4574/06.03.2019 të ZBD Ferizaj.

Me këtë aktvendim, është konstatuar se Sektori i Pranimit Qendror, subjektit në procedurë i ka kontestuar vlerën e mallit lëndor sipas Deklaratës Unike Doganore të lartcekur, duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në procesin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave ka cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit nenit 35, të Kodit doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme që Dogana e Kosovës ka në Dispozicion.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 17.05.2021, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lënë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr. 01.3.2.2/4141 datë 20.05.2023. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, sepse paditësi në procedurë ankimore tek e paditura, por edhe në këtë procedurë gjyqësore, nuk ka arritur që me prova bindëse të dëshmoj vlerën e deklaruar të mallit lëndor, siç kërkohet me nenin 31 par.1 të KDAK-së, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrativo-juridike. Tutje është theksuar se Gjykata konstaton se paditësi për të provuar vlerën e deklaruar të mallit lëndor përmes DUD-it të cekur, në procedurë administrative tek e paditura, por edhe në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ ka paraqitur si provë faturën me nr.TECH1802 të lëshuar nga eksportuesi “Xiang Xing Hardware Manufactory” nga Kina, në shumë prej 31,647.75 USD, aq sa është vlera e deklaruar e mallit, mirëpo gjykata vlerëson se në rastin konkret përmes kësaj fature nuk mund të provohet vlera e deklaruar e mallit nga paditësi, sepse kjo faturë nga përmbajtja e saj nuk dihet së për kënd është lëshuar. Në faturë nuk janë shënuar të dhënat e paditësit dhe si e tillë kjo faturë nuk mund të konsiderohet si faturë e rregullt dhe në përputhje me dispozitat e nenit 91 dhe 123 të UA nr.11/2009, ngase në këtë rast edhe shitësi/

eksportuesi, por edhe blerësi/importuesi kanë qenë biznese dhe se në faturë është dashur të shënohen të dhënat e paditësit si blerës i mallit, për tu konsideruar faturë e rregullt.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetojë një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se paditësi nuk ka prezantuar fakte të bazuara që argumentojnë se ka paguar vlerën reale të mallit sipas faturave përcjellëse të mallit lëndor, pasi që nuk ka prezantuar transaksionin bankar apo çfarëdo pagese tjetër për mallin e importuar konform nenit 33 të KDAK-së i cili nen parasheh që *“Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë”*. Paditësi ka paraqitur urdhërpagesat bankare ndërkombëtare të datës 16.11.2018 në shumë prej 10,000.00USD dhe atë të datës 28.01.2019 në shumë prej 21,647.75€, ku përshkrimi bankar i këtyre dy faturave është “pagesë për mall”, pa e specifikuar numrin e faturës për të cilën bëhet pagesa e mallit siç kërkohet më dispozitat e nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.1025/22, me datë 18.12.2023

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova